



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3032 Prot

Shkodër, më 26.09.2025

V E N D I M

Nr. 248 Datë 26.09.2025

**"PËR ANULLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURSIT PUBLIK PËR POZICIONIN
ADMINISTRATOR I USH-SË DHE MIRATIMIN E KRITEREVE
TË RISAKTËSUARA"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika 1, gërmat f) dhe g); Ligjin nr. 8480 datë 27.05.1999 "Për funksionin organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; Statutin e USH-së, neni 36, pika 2; Bordi i Administrimit pasi konstatoi lapsusin tek pika 1, e kriterëve specifike për këtë pozicion, miratuar me Vendimin e BA-së nr. 231, datë 08.09.2025, vlerëson se, procedura e konkursit nuk mund të vijojë pa u kryer korrigjimi i nevojshëm konform përcaktimit të Statutit të USH-së, neni 36, pika 6. Për këtë arsye, BA, me Vendim qarkullues të datës 26.09.2025,

V E N D O S I:

1. Anullimin e procedurës së konkursit publik për pozicionin e Administratorit të USH-së, të shpallur në APP, në Buletin e Njoftimeve Publike nr. 51, datë 15.09.2025.
2. Korrigjimin e pikës 1, të kriterëve specifike, duke zëvendësuar lidhëzen **"dhe"** me lidhëzen **"ose"**, si vijon: *"Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushat e Shkencave Ekonomike ose Juridike, në sistemin me kohë të plotë (Bachelor) dhe (Master e Shkencave Ekonomike ose Juridike, në sistemin me kohë të plotë (Bachelor) dhe (Master e Shkencave; Program Studimi i Integruar i Ciklit të Dytë ose program studimi 4- vjeçar). Niveli minimal i diplomës për efekt kandidimi në këtë pozicion është "Master i Shkencave". (Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria Përgjegjëse).*
3. Miratimin e kriterëve të punësimit në pozicioni "Administrator i USH-së", si dhe shpalljen e tyre në APP, sipas materialit bashkëngjitur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka

